

Jeta e Beqarit (pjesa 1)

ZGJEDHJET PER SHËNDET SHPIRTËROR

Mire se erdhët në familjen e kishës sonë. Sot fillojmë një seri të re, Jeta e Beqarit. Sot kemi temën "Mundësitë për Shëndet Shpirtëror".

Po lexoja për katër shtyllat e besimit që kishte pastori i një shërbese të rinjsh, dhe ato ishin: rritja shpirtërore, miqësitë ose shoqëritë e shëndetshme, pastërtia seksuale dhe ndryshimi që mund të sjellim në botë. Kur i lexova, unë, si burrë i martuar, thashë: "Do të jetë diçka e mirë këtu."

Për ata që janë të martuar, mos ejani këto javë në kishë. Shaka! Kjo është një mundësi shumë e mirë për të ftuar beqarët. Mos u mërzisni, ju të martuarit, sepse do të bëjmë një seri predikimesh edhe për ju. Por ju siguroj që do të jetë një temë e bukur për të gjitha grupmoshat.

Sot do të flasim për diçka që është e përbashkët si për beqarin, ashtu edhe për të martuarin: shëndeti i jetës sonë shpirtërore. Ne jemi vetë përgjegjës për gjendjen e njeriut tonë të brendshëm, për jetën tonë. Sepse vetëm një gjë do të marrim me vete kur të jemi me Zotin: shpirtin tonë. Sfidat për të pasur një jetë shpirtërore të shëndetshme është për të gjithë, por ne duhet të bëjmë zgjedhjet tona që na sigurojnë këtë shëndet.

Pra, pyetja që do t'i përgjigjemi sot është: **Cilat janë zgjedhjet që ne duhet të bëjmë çdo ditë për të na ndihmuar të kemi një jetë shpirtërore të shëndetshme?**

Përgjigjet do t'i gjejmë te Eksodi, kapitulli 4, ku do të shohim se si Moisiu bëri të njëjtat pyetje përpara se Perëndia ta dërgonte në Egjipt. Perëndia i tha: "Para se të nisesh, dua që ti të bësh disa zgjedhje."

Moisiu u rrit në Egjipt. Ai ishte rritur si princ në oborrin e faraonit, por një ditë, pasi vrau një egjiptas që po torturonte një izraelit, u detyrua të ikte dhe u vendos në Midian. Aty, ai u martua dhe u bë bari në shtëpinë e vjehrrit të tij.

Ndoshta Moisiu kishte menduar se jeta e tij tashmë ishte vendosur dhe se nuk kishte më sfida të mëdha përpara. Por Perëndia i erdhi dhe i tha: "Moisi, tani është koha. Kthehu në Egjipt dhe thuaj faraonit: 'Lëre popullin tim të shkojë.'"

Moisiut i hyri frika. Ai filloi t'i thotë Perëndisë: "Po sikur të mos jem i aftë ta bëj? Po sikur të them që do ta bëj, por kur ta shoh sa e vështirë është, ta lë përgjysmë? Po sikur të shkoj dhe askush të mos më besojë?"

Ja ku është realiteti: ti dhe Moisiu, ne dhe Moisiu kemi mundësi të jetojmë jetën tonë me Perëndinë, por kjo gjithmonë është e përzier me gëzim dhe frikë. Të dyja na shoqërojnë në rrugën tonë kur vendosim të jetojmë për Krishtin.

Ka gëzim sepse besimi tek Ai na jep shpresë dhe siguri për të ardhmen. Por ka edhe frikë, sepse ndonjëherë mendojmë: “Po sikur unë të mos jem aq besimtar/e sa duhet? Po sikur unë të mos i bindem të gjitha rregullave?”

Lajmi i mirë është se Perëndia nuk habitet nga frikërat tona. Kur të lexosh Eksodin 4, do të shohësh që Perëndia nuk habitet fare me frikërat që ka Moisiu. Ai nuk u dorëzua përballë dyshimeve të Moisiut, por i tha: “Nëse ti bën këto zgjedhje çdo ditë, do të jesh në gjendje të realizosh lehtësisht çdo gjë që të them Unë.”

Por cilat janë këto zgjedhje? Tek Eksodi 4, do të shikojmë tri prej tyre. Ashtu siç Perëndia e ndihmoi Moisiun të ishte i fortë shpirtërisht nëse bënte këto zgjedhje, ashtu do të na ndihmojë edhe ne.

Eksodi 4:1-4 *'Moisiu u përgjigj dhe tha: "Por ja, ata nuk do të më besojnë [a të thashë që kështu do reagonte Moisiu] as do t'i binden zërit tim, sepse do të thonë: "Zoti nuk të është shfaqur"'. Atëherë Zoti i tha: "Ç'është ajo që ke në dorë?". Ai u përgjigj: "Një bastun". Zoti tha: "Hidhe për tokë". Ai e hodhi për tokë, dhe ai u bë një gjarpër, para të cilit Moisiu iku me vrap. [po normale, edhe ti po të kishe qenë, të të thoshte Zoti të hidhje çfarë kishe në dorë, p.sh. celularin, dhe të bëhej gjarpër, do ia mbathje vrapit] Atëherë Zoti i tha Moisiut: "Zgjate dorën dhe kape nga bishti" [po e kape nga bishti, gjarpri të hidhet, në fakt gjarpri kapet nga koka, por Moisiu bindet dhe...]. (Ai zgjati dorën dhe e mori, dhe në dorën e tij ai u bë një bastun).'*

Zgjedhja #1 për një jetë të shëndetshme shpirtërore: **Përdore me kujdes fuqinë tënde.**

Moisiu ishte bari, dhe shkopi ishte një element jetësor për bariun. Në atë kohë, mbajtja e shkopit nuk ishte diçka moderne, por ai e përdorte atë nëse kishte ndonjë rrezik, sepse nuk kishte asnjë armë për të mbrojtur veten nga ujqërit. Shkopi ishte një shok për të, një mjet i nevojshëm pune. Pa të, ai nuk mund të kujdesej për delet. Për Moisiun, ai shkop nuk ishte thjesht një objekt; ai përfaqësonte suksesin e jetës së tij. Kur Perëndia i kërkoi Moisiut të hidhte shkopin, ai po i kërkonte të linte mjetin më të rëndësishëm që kishte, armën e tij, mburojën e tij. Me atë shkop, ai ruante jetën e vet dhe të deleve. Pa të, ai ndjehej i pambrojtur.

Pse është kjo gjë e rëndësishme? Sepse që Perëndia të përdorë diçka, duhet ta zotërojë Ai fillimisht.

Ajo që Perëndia i kishte dhënë Moisiut nuk ishte e tij; ishte e Perëndisë. Çdo gjë që ke—familja jote, puna jote, paratë e tua, shoqëria që ke—Perëndia e përdor çdo gjë që ke për qëllimin e tij. E gjithë jeta jote plotëson qëllimin e Perëndisë për të cilin Ai të ka vendosur në tokë. Asgjë nuk është rastësore. Prandaj, nëse nuk jemi të kujdesshëm, është e lehtë të mos e vëmë re këtë.

Ne jetojmë në një brez që mendon se çdo gjë që kanë në jetë është e tyre dhe mund të bëjnë me të çfarë të duan. “Trupi është i imi, paratë, fundjava, shtëpia, puna—gjërat janë të mia. Mund të bëj çfarë të dua me gjithçka që kam.”

Nëse nuk jemi të kujdesshëm, ne si besimtarë mund ta harrojmë këtë. Por e vërteta është se në momentin që ti dhe unë i kemi dhënë jetën Krishtit, ne e kemi lënë në duar të Tij çdo gjë nga jeta jonë. Ne nuk kemi më të drejta mbi jetën tonë; ne kemi vetëm përgjegjësi. Prandaj, përdore me kujdes fuqinë tënde, atë që ke.

Eksodi 4:6 *'Zoti i tha akoma: "Tani vër dorën në gjirin tënd". Dhe ai vuri dorën e tij në gji dhe pastaj e tërhoqi, dhe ja, dora ishte lebrosur, e bardhë si bora.'*

Ja ku po bisedon Perëndia me Moisiun përsëri. Perëndia i kërkon të vendosë dorën brenda nën rrobë, dhe kur e nxjerr, ajo ishte bërë me lebrë. Do të ketë qenë e frikshme, sepse lebra ishte një sëmundje vdekjeprurëse, e cila përhapej në të gjithë trupin derisa e kalbte. Perëndia i kërkon ta fusë përsëri dorën brenda, dhe ajo pastrohet.

Eksodi 4:7 *'Zoti i tha akoma: "Vëre përsëri dorën në gjirin tënd". Ai e vuri përsëri dorën e tij në gji dhe pastaj e tërhoqi nga gjiri, dhe ja, ajo ishte bërë njëlloj si mishi i tij.'*

Po kjo çfarë lidhje ka me ne?

Lebra është diçka e pistë që përhapet, dhe mëkati është njësoj si lebra. Nëse nuk shërohet, ai përhapet derisa e kalb shpirtin tonë, duke na lënë pa forcë shpirtërore.

Për shembull, nëse nuk e falim një person, dhe nuk merremi me këtë, fillojmë të mos falim as të tjerët. Kjo bëhet zakon, dhe përfundimisht nuk flasim më me shumë njerëz, duke filluar vetëm me një mosfalje.

Po ashtu, ndjenja e hidhërimit, cinizmi, fryma kritike dhe e negativitetit. Në fillim, shikojmë diçka me frymë kritike vetëm tek vetja jonë, dhe më pas fillojmë të shohim gjithçka në botë me frymë negative. Kjo është natyra e lebrës shpirtërore; ajo përhapet në shpirtin tonë dhe na dëmton.

Çfarë do t'i thoshte Perëndia Moisiut për këtë?

Zgjedhja 2#: **Urreje pisllekun në zemrën tënde.**

Perëndia po i thoshte Moisiut, “Jo vetëm që ta dish se ka diçka në zemrën tënde me të cilën duhet të merresh, por duhet ta urresh aq shumë sa të bësh diçka për ta rregulluar.” Kjo dora mbi zemër, ja ta them se çfarë kuptimi ka. Dora përfaqëson thirrjen e Moisiut. Ai ishte i thirrur për ta çliruar popullin e Izraelit nga Egjipti, nga duart e liga të Faraonit. Dora mbi zemër përfaqëson njeriun e brendshëm, si ishte Moisiu brenda.

Nëse ka ndonjë gjë të keqe brenda teje, ajo do të përhapet si lebra dhe do të shikohet në sjelljen tënde. Çfarë ka zemra, nxjerr goja. Nëse ruajmë gjëra të këqija brenda vetes, këto do të dëmtojnë shoqërinë tonë dhe do të ndikojnë në punën, paratë, çdo gjë. Kjo është natyra e pislëkut shpirtiror. Prandaj tha Davidi tek:

Psalmet 24:3 *'Kush do t'i ngjitet malit të Zotit? Kush do të qëndrojë në vendin e tij të shenjtë?'*

Psalmet 24:4 *'Njeriu i pafajshëm nga duart dhe i pastër nga zemra, që nuk e ngre shpirtin për t'u dukur dhe nuk betohet në mënyrë të rreme.'*

Tek **Jakobi 4:8b** *'... pastroni duart tuaja, o mëkatarë; dhe pastroni zemrat o njerëz me dy mendje!'*, Perëndia vendos një çmim për pastërtinë shpirtërore, nuk e neglizhon. Pra, duhet ta urresh diçka aq shumë sa të bësh diçka për ta ndryshuar.

Le të flasim për diçka që e urren ti. P.sh. sa nga ju iu acarohen nervat nga diçka që bën një person i familjes apo një shok?

P.sh., beqarët e kanë bezdi kur i pyesin: “Po hë, kur do martohesh?”

“A më lë rehat? Këta të martuarit vetëm këtë pyetje kanë.”

Dhe shpesh ne i vëmë kaq rëndësi këtyre gjërave të vogla, por nuk i vëmë aq rëndësi, dhe nuk kemi aq pasion për Perëndinë.

Çfarë bëjmë me gjërat që na acarojnë shpirtërisht?

Hiç, i injorojmë të gjitha dhe merremi me gjëra të vogla. Dhe kur na pyet dikush se pse sillemi kështu, themi: “Epo kështu jam unë.” Por natyra e mëkatit është e tillë që nëse e lëmë të rrijë në zemrën tonë, ajo përhapet dhe prek çdo zonë të jetës tonë.

Ajo që duhet të bëjmë është të jemi të sinqertë me veten dhe të themi: “Mjaft kam ruajtur në zemrën time inat, zili, lakmi, hidhërim, urrejtje. Këto gjëra po më gërryejnë. Por thahem shpirtërisht.”

Po pse është e rëndësishme të jesh i sinqertë me veten? Sepse kjo nuk është gjë e lehtë. Por kur i bën grafik zemrës tënde për të parë se çfarë ka aty dhe për t'i

kërkuar Perëndisë falje dhe pastrim, kjo do ta fuqizojë jetën tënde. Sepse kur ti pranon gabimin tënd, kjo i hap rrugë, e lejon Krishtin të veprojë në jetën tënde.

Çfarë ndodh nëse ti e përdor fuqinë tënde me kujdes dhe urren pisllekun e zemrës tënde?

Zgjedhja 3#: **Pranoje këshillën e Perëndisë.**

Eksodi 4:9 *'Por, në rast se ata nuk do t'u besojnë as këtyre dy shenjave dhe nuk do t'i binden zërit tënd, ti atëherë merr ujë nga lumi dhe derdhe mbi tokë të thatë; dhe uji që do të kesh marrë nga lumi do të bëhet gjak mbi tokën e thatë.'*

Nëse nuk e ke lexuar Dhjatën e Vjetër, të duket habi. Uuu, gjak në tokë të thatë. Nuk ndodh shpesh në lagjen time.

Perëndia po e këshillon Moisiun, Ai po i thotë, "Këto shenja do të ndodhin kur të them unë, jo në kohë të papërshtatshme. Ti nuk do t'i bësh këto shenja kur të inatosesh me njerëzit, apo do të tregosh sa i fortë je te djemtë e lagjes. Ti do t'i bësh këto shenja vetëm kur të them unë. "

Eksodi 4:12 *'Dhe tani shko, unë do të jem me gojën tënde dhe do të të mësoj atë që duhet të thuash.'*

Perëndia po i thoshte, "Moisi, ti nuk e di se ku po shkon dhe se çfarë do të ndodhë, por unë e di. Prandaj, unë do të të mësoj, do të të këshilloj, unë do të të udhëzoj në jetën tënde. Nëse unë të them mos e bëj këtë gjë, mos e bëj; kur të them bëje, vepro. Ti vetëm më beso Mua."

Çfarë do të thotë të pranosh këshillën e Perëndisë? Do të thotë të jesh i mësueshëm. Të jesh i gatshëm për të pranuar atë që di dhe atë që nuk di. Të pranosh këshillën e Perëndisë do të thotë të bësh atë që Ai të thotë. Të mos jesh kokëfortë.

Problemi në jetën e krishterë nuk është as që Jezusi është Biri i Perëndisë, as nëse vdiq apo jo në kryq, apo u ringjall apo jo. Kjo nuk diskutohet. Ajo që është problem, pavarësisht nga mosha apo gjendja martesore, është kokëfortësia. Na pëlqejnë rrugët tona, idetë tona; ne dimë më mirë se çfarë duhet bërë.

Sigurisht që kemi arsytet tona pse jemi kokëfortë. "Unë nuk jam i zemëruar, as nuk urrej dikë, por jam pak kokëfortë."

Marku 10:15 *'Në të vërtetë po ju them se kushdo që nuk e pranon mbretërinë e Perëndisë si një fëmijë i vogël, nuk do të hyjë në të.'*

A jemi të gatshëm të lëshojmë kokëfortësinë tonë dhe të pranojmë udhëzimet e Tij si fëmijë? A jemi të hapur për të ndryshuar dhe për t'u përmirësuar, duke i besuar Atij?

Nëse duam të hyjmë në mbretërinë e Perëndisë, duhet të heqim dorë nga mendësitë e ngurta dhe të jemi të gatshëm të pranojmë dhe të zbatojmë këshillat e Tij.

Le të lutemi.